REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.1168 prot**

**Libohovë më 15.06.2026**

**VENDIM**

**Nr. 27 Datë 10.06.2026**

**PËR**

**SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025, NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Në mbështetje të nenit 41 , të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 4 dhe 27 , të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 I ndryshuar , "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar , të nenit 36 të ligjit Nr. 68/2017, " Për financat e vetëqeverisjes vendore" I ndryshuar , ligji Nr. 87/2025, datë 12.12.2025 " Për buxhetin e vitit 2026", si dhe të Vendimit Nr.70, datë 24.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Libohovë, me propozim të Kryetaritt ë Bashkisë , në mbledhjen e datës 09.06.2026,ligji Nr. 87/2025, datë 12.12.2025 " Për buxhetin e vitit 2026", si dhe të Vendimit Nr.70, datë 24.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Libohovë, me propozim të Kryetaritt ë Bashkisë , në mbledhjen e datës 10.06.2026,

**VENDOSI**

**I.** Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve , pjesë e Buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2026, si më poshtë:

| NR | EMERTIMI | TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE | TË ARDHURAT E VETA |
|---|---|---|---|
| I | **TË ARDHURAT** | | |

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 në 31.12.2025 | 46,527,392.05 | 26,468,331.51 |
| | **Të ardhurat e trashëguara për t'u shpërndarë** | **46,527,392.05** | **26,468,331.51** |
| **II** | **SHPENZIME** | | |
| 1 | Shpenzime për paga (600) | 324,824.00 | 2,855,176.00 |
| 2 | Shpenzime për sigurime (601) | 46,092.00 | 523,908.00 |
| 3 | Shpenzime operative (602) | 18,758,614.00 | 7,763,054.11 |
| 4 | Shpenzime trasferime (604) | 0 | 616,000.00 |
| 6 | Shpenzime fondi rezervë (609) | 0 | 1,800,000.00 |
| 7 | Shpenzime kapitale të patrupëzuara (230) | 341,160.00 | 92,160.00 |
| 8 | Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) | 27,056,702.05 | 12,818,033.40 |
| | **SHPENZIME GJITHËSEJ** | **46,527,392.05** | **26,468,331.51** |

**II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Asim Banushaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 110 Prot Libohovë , më 09 . 06 .2026

# PROJEKT -VENDIM

Nr._____, Datë ___.___.2026

## PËR
## SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025, NË BUXHETIN E VITIT 2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar , të ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore" , ligji Nr. 87/2025, datë 12.12.2025 " Për buxhetin e vitit 2026", si dhe të Vendimit Nr.70, datë 24.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës ___.___.2026, pasi morri në shqyrtim relacionin nga Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar,

## VENDOSI :

**I.** Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve , pjesë e Buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2026, si më poshtë:

| NR | EMERTIMI | TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE | TË ARDHURAT E VETA |
|---|---|---|---|
| I | TË ARHURAT | | |
| 1 | Të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 në 31.12.2025 | 46,527,392.05 | 26,468,331.51 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Të ardhurat e trashëguara për t'u shpërndarë** | **46,527,392.05** | **26,468,331.51** |
| **II** | **SHPENZIME** | | |
| 1 | Shpenzime për paga (600) | 324,824.00 | 2,855,176.00 |
| 2 | Shpenzime për sigurime (601) | 46,092.00 | 523,908.00 |
| 3 | Shpenzime operative (602) | 18,758,614.00 | 7,763,054.11 |
| 4 | Shpenzime trasferime (604) | 0 | 616,000.00 |
| 6 | Shpenzime fondi rezervë (609) | 0 | 1,800,000.00 |
| 7 | Shpenzime kapitale të patrupëzuara (230) | 341,160.00 | 92,160.00 |
| 8 | Shpenzime kapitale të trupëzuara (231) | 27,056,702.05 | 12,818,033.40 |
| | **SHPENZIME GJITHËSEJ** | **46,527,392.05** | **26,468,331.51** |

II. Pwr zbatimin e kwtij vendimi ngarkohet Sektori i Financws dhe Menaxhimit Financiar pranw Bashkisw Libohovw.

III. Ky vendim u shpall sot mw datw ___.___.2026 dhe hyn nw fuqi pas miratimit nga prefektura.

**JURISTI** **SHEF SEK. FINANCIAR** **KRYETARI**

**Kristaq Ciko** **Joana Memo** **Leonard Hide**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë.Tel :00355881220091,bashkialibohove@outlook.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBOHOVË**

# RELACION

## PËR SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025, NË BUXHETIN E VITIT 2026

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Libohovë, në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar , të ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore" , miratoi Buxhetin e institucionit për vitin 2025 me të ardhur gjithsej 219,415,331.76 lekë dhe shpenzime gjithësej 146,419,608.2 lekë.

Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve deri ne 31.12.2025 është në total 72,995,723.56 lekë ku vlera 46,527,392.05 lekë i përket Kapitullit 1 dhe 26,468,331.51 lekë i përket Kapitullit 5.

Realizimi i buxhetit për 2025 është në masën 66.73%.
Sa më sipër lind nevoja për rregullimin në Buxhetin Fillestar , duke bërë planifikimin e saktë të burimeve të financimit dhe shpërndarjes së shpenzimeve. Bazuar në ligjin Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 28, pika 5, i cili citon se: **"Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore në fund të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transferta specifike për funksionin për të cilin janë dhënë këto fonde, ato trashëgohen për të njëjtin funksion në vitin pasardhës buxhetor"** si dhe në udhëzuesin plotësues për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2026 me Nr.677/1Prot , të datës 14.01.2026 në pikat 108 dhe 109 si më poshtë vijon:

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

**108.** Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme të trashëguara nga viti 2025, rregjistrohen në Kapitullin 01, për t'iu shtuar fondeve të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme nga qeverisja qendrore për vitin 2026.

**109.** Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve, të trashëguara nga viti 2025, rregjistrohen në Kapitullin 01, për t'iu shtuar fondeve të transfertës së pakushtëzuar sektoriale nga qeverisja qendrore për vitin 2026. Këto fonde do të përdoren për të rritur cilësinë e shërbimit në këto sektorë.

| GRUPI | | TITULLI | KAPITULLI | ARTIKULLI | EMERTIMET | TRASHEGUAR |
|---|---|---|---|---|---|---|
| APARATI | 0 | 1110 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 1110 | 1 | **6021** | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6021099 | TE TJERA METERIALE DHE SHERBIME SPECIALE | 120,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | **6022** | **SHERBIME NGA TE TRETET** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6022004 | POSTA DHE SHERBIMI KORIER | 100,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 6022011 | KOSTO E TRAJNIMIT DHE SEMINARE | 120,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 6022099 | SHERBIMETE TJERA | 612,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 751,200.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 6023300 | SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE | 25,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | **6024** | **SPENZIME UDHETIMI** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6024100 | UDHETIME BRENDA VENDIT | 100,000.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 1110 | 1 | **6025** | **SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6025600 | SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT | 22,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | **6029** | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | |
| | 0 | 1110 | 1 | 6029008 | SHPENZIME PER TATIME&TAKSA TE PA PAGUARA NGA INSTITUCIONI | 30,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 6029099 | SHPENZIME TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | 800,000.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **2,680,200.00** |
| **ARSIM FILLOR** | 0 | 9120 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 9120 | 1 | **6020** | **MATERIALE ZYRE DHE TE PERGJITHESHME** | |
| | 0 | 9120 | 1 | 6020200 | MATERIALE PASTRIM, DEZIFEKTIM, NGROHJE DHE NDRICIM | 100,000.00 |
| | 0 | 9120 | 1 | **6022** | **SHERBIME NGA TE TRETET** | |
| | 0 | 9120 | 1 | 6022005 | SHERBIM PER NGROHJE | 383,000.00 |
| | 0 | 9120 | 1 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 9120 | 1 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ (GAZ I LENGSHEM) | 194,700.00 |
| | 0 | 9120 | 1 | **6029** | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | |
| | 0 | 9120 | 1 | 6029099 | SHPENZIME TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | 340,000.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **1,017,700.00** |
| **ARSIM** | 0 | 9230 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 9230 | 1 | **6022** | **SHERBIME NGA TE TRETET** | |
| | 0 | 9230 | 1 | 6022002 | UJE | 5,000.00 |
| | | | | | TOTALI | 5,000.00 |
| KULLIM UITJE | 0 | 4240 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 4240 | 1 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 4240 | 1 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 1,326,493.48 |
| | 0 | 4240 | 1 | 6023200 | PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI | 1,627,193.20 |
| | 0 | 4240 | 1 | 6023300 | SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE | 16,500.00 |
| | 0 | 4240 | 1 | 6023900 | SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI | 68,000.00 |
| | 0 | 4240 | 1 | **6025** | **SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME** | |
| | 0 | 4240 | 1 | 6025600 | SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT | 5,000.00 |
| | | | | | TOTALI | 3,043,186.68 |
| | 0 | 4240 | 5 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 4240 | 5 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 2,866,806.52 |
| | | | | | TOTALI | 2,866,806.52 |
| PYJET | 0 | 4260 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 4260 | 1 | **6021** | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | |

Adresa:Rruga“AvniRustemi”,Lagjia“Linua”,Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 4260 | 1 | 6021002 | PLEHRA KIMIK, FURNITURA VETERINARE, FARERA, FIDANA E TE TJERA PRODUKTE AGROKULTURORE | 2,758,857.08 |
| | 0 | 4260 | 1 | 6021010 | SHPENZIME PER PRODHIM DOKUMENTACIONI SPECIFIK | 2,500,000.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **5,258,857.08** |
| RRUGET RURALE | 0 | 4520 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 4520 | 1 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 4520 | 1 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 2,026,000.00 |
| | 0 | 4520 | 1 | 6023200 | PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI | 304,520.00 |
| | 0 | 4520 | 1 | 6023300 | SHPENZIMET E SIGURACIONIT TE MJETEVE | 27,000.00 |
| | 0 | 4520 | 1 | 6023900 | SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI | 109,000.00 |
| | 0 | 4520 | 1 | **6025** | **SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME** | |
| | 0 | 4520 | 1 | 6025600 | SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT | 12,000.00 |
| | 0 | 4520 | 1 | **6029** | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | |
| | 0 | 4520 | 1 | 6029099 | SHPENZIME PER TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | 1,528,317.83 |
| | | | | | **TOTALI** | **4,006,837.83** |
| MBETJET | 0 | 5100 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 5100 | 1 | **6023** | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHERBIMET PUBLIKE | 0 | 5100 | 1 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 1,236,037.14 |
| | 0 | 5100 | 1 | 6023200 | PJESE KEMBIMI, GOMA DHE BATERI | 734,580.00 |
| | 0 | 5100 | 1 | 6023900 | SHPENZIME TE TJERA TRANSPORTI | 12,000.00 |
| | 0 | 5100 | 1 | | **SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME** | |
| | 0 | 5100 | 1 | 6025600 | SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E MJETEVE TE TRANSPORTIT | 63,600.00 |
| | | | | | TOTALI | 2,046,217.14 |
| | 0 | 5100 | 5 | | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 5100 | 5 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 52,062.86 |
| | | | | | TOTALI | 52,062.86 |
| | 0 | 6260 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| | 0 | 6260 | 1 | **6021** | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | |
| | 0 | 6260 | 1 | 6021002 | PLEHRA KIMIK, FURNITURA VETERINARE, FARERA, FIDANA E TE TJERA PRODUKTE AGROKULTURORE | 75,615.27 |
| | | | | | TOTALI | 75,615.27 |
| | 0 | 6260 | 5 | 600 | PAGA | 1,600,000.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | 601 | SIGURIME SHOQERORE | 300,000.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 6260 | 5 | **6020** | **MATERIALE ZYRE DHE TE PERGJITHESHME** | |
| | 0 | 6260 | 5 | 6020200 | MATERIALE PASTRIM, DEZIFEKTIM, NGROHJE DHE NDRICIM | 800,000.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | **6021** | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | |
| | 0 | 6260 | 5 | 6021002 | PLEHRA KIMIK, FURNITURA VETERINARE, FARERA, FIDANA E TE TJERA PRODUKTE AGROKULTURORE | 44,384.73 |
| | 0 | 6260 | 5 | 6021099 | TE TJERA METERIALE DHE SHERBIME SPECIALE | 500,000.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | **6029** | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | |
| | 0 | 6260 | 5 | 6029099 | SHPENZIME PER TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | 1,570,000.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | | **SHPENZIME TRANSPORTI** | |
| | 0 | 6260 | 5 | 6023100 | KARBURANTE DHE VAJ | 229,800.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **5,044,184.73** |
| **MZSH** | 0 | 3280 | 1 | | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | - |
| | 0 | 3280 | 1 | 6021001 | IUNIFORMA DHE VESHJE TE TJERA SPECIALE | 100,000.00 |
| | 0 | 3280 | 1 | | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | - |
| | 0 | 3280 | 1 | 6029099 | SHPENZIME TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | - |
| | | | | | **TOTALI** | **100,000.00** |
| | | | | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | |
| **KULTURA** | 0 | 8220 | 1 | **6021** | **MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE** | - |

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 8220 | 1 | 6021007 | LIBRA DHE PUBLIKIME PROFESIONALE | 520,000.00 |
| | 0 | 8220 | 1 | **6022** | **SHERBIME NGA TE TRETET** | - |
| | 0 | 8220 | 1 | 6022002 | UJE | 5,000.00 |
| | 0 | 8220 | 1 | | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | - |
| | | | | | TOTALI | 525,000.00 |
| | 0 | 8220 | 5 | **6024** | **SHPENZIME UDHETIMI** | - |
| | 0 | 8220 | 5 | 6024100 | UDHETIM I BRENDSHEM | 500,000.00 |
| | 0 | 8220 | 5 | 6024200 | UDHETIM I JASHTEM | 700,000.00 |
| | 0 | 8220 | 5 | | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | - |
| | 0 | 8220 | 5 | 6029099 | SHPENZIME TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | 500,000.00 |
| | | | | | TOTALI | 1,700,000.00 |
| SOCIALE | 0 | 10430 | 1 | 600 | PAGA | 324,824.00 |
| | 0 | 10430 | 1 | 601 | SIGURIME SHOQERORE | 46,092.00 |
| | 0 | 10430 | 1 | **602** | **SHPENZIME OPERATIVE** | - |
| | 0 | | 1 | | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | - |
| | 0 | 10430 | 1 | 6029099 | SHPENZIME TE TJERA MATERIALE DHE SHERBIME OPERATIVE | - |
| | | | | | TOTALI | 370,916.00 |

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 10430 | 5 | 600 | PAGA | 1,255,176.00 |
| | 0 | 10430 | 5 | 601 | SIGURIME SHOQERORE | 223,908.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **1,479,084.00** |
| 604 | 0 | 1110 | 5 | **604** | **TRANSFERIME** | - |
| | 0 | 1110 | 5 | 6040009 | TRANSFERIME TEK NIVELE TE TJERA TE QEVERISE | 616,000.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **616,000.00** |
| 4% | | | | **609** | **REZERVAT** | |
| | 0 | 4980 | 5 | 6091000 | **EMERGJENCA 4% SHTUAR BUXHETIT FILLESTAR** | 1,800,000.00 |
| | | | | | **TOTALI** | **1,800,000.00** |
| **INVESTIME 230-231 (2025-2026)** | | | | | | **40,308,055.45** |
| 1110 | 0 | 1110 | 1 | 230 | MBIKQYRJE " NDERHYRJE NE SHTEPINE E TE MOSHUARVE LIBOHOVE (PROKURIN NGA 2025) | 37,440.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 230 | KOLAUDIM " NDERHYRJE NE SHTEPINE E TE MOSHUARVE LIBOHOVE (PROKURIM NGA 2025) | 3,720.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 230 | HARTIM I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI UJESJELLESIT SHEPER" | 300,000.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 231 | NDERTIMI I KENDIT TE LOJRAVE LIBOHOVE | 866,507.00 |
| | 0 | 1110 | 1 | 231 | RRUGET E BRENDESHME NE LAGJEN TEQE FUSHE | 6,272,686.23 |
| | 0 | 1110 | 5 | 231 | RRUGET E BRENDESHME NE LAGJEN TEQE FUSHE | 4,637,713.03 |

BASHKIA LIBOHOVE

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 1110 | 5 | 230 | Mbykqyrje SHTRIM ME BETON I RRUGEVE TE BRENDESHME NE LAGJEN BAILLO (PROKURIM NGA 2025) | 92,160.00 |
| | | 1110 | | | TOTALI | 12,210,226.26 |
| 4520 | 0 | 4520 | 1 | 231 | RIKONSTRIKSIONI I KALLDREMIT NE FSHATIN NEPRAVISHTE FAZA II DHE PERFUNDIMTARE (PROKURIM NGA 2025) | 1,752,000.00 |
| | | 4520 | | | TOTALI | 1,752,000.00 |
| 6260 | 0 | 6260 | 1 | 231 | SHTRIM ME BETON I RRUGEVE TE BRENDESHME NE LAGJEN BAILLO **(PROKURIM NGA 2025)** | 2,839,880.40 |
| | 0 | 6260 | 5 | 231 | SHTRIM ME BETON I RRUGEVE TE BRENDESHME NE LAGJEN BAILLO **(PROKURIM NGA 2025)** | 3,990,735.60 |
| | 0 | 6260 | 5 | 231 | SHTRIM ME BETON I RRUGEVE TE BRENDESHME NE LAGJEN BAILLO **(PROKURIM NGA 2025) SHTESA DERI NE 20% TE KONTRATES** | 1,074,680.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | 231 | SHTRIM ME KALLDREM I RRUGES PER TEK KULLA E SAHATIT LIBOHOVE | 121,096.00 |
| | 0 | 6260 | 1 | 231 | BLERJE AUTOBETONJERE PER NEVOJAT E BASHKISE | 1,258,737.00 |
| | 0 | 6260 | 5 | 231 | BLERJE AUTOBETONJERE PER NEVOJAT E BASHKISE | 700,000.00 |
| | | 6260 | | | TOTALI | 9,985,129.00 |
| 9120 | 0 | 9120 | 1 | 231 | RESTAURIM I PJESSHEM I CATISE SE SHKOLLES AVNI RUSTEMI LIBOHOVE | 500,000.00 |
| | 0 | 9120 | 1 | 231 | RESTAURIM I CATISE SE SHKOLLES SE LABOVES SE SIPERME | 650,000.00 |
| | 0 | 9120 | 1 | 231 | SHTRIMI I SHESHIT PERPARA SHKOLLES NE BULO DHE NDERTIMI I | 1,298,559.00 |

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | KANALIT TE UJRAVE | |
| | 0 | 9120 | 1 | 231 | BLERJE LAPTOP, PRINTER-FOTOKOPJE-SKANER DHE MATERIALE TE TJERA NDIHMESE | 140,948.55 |
| | 0 | 9120 | 1 | 231 | TAPET BARI PLASTIK PER FUSHEN SPORTIVE NE NEPRAVISHTE DHE KENDI I LOJRAVE NE DRINO | 1,200,000.00 |
| | | 9120 | | | **TOTALI** | **3,789,507.55** |
| **9230** | 0 | 9230 | 1 | 231 | BLERJE LAPTOP, PRINTER-FOTOKOPJE-SKANER DHE MATERIALE TE TJERA NDIHMESE | 1,801,661.91 |
| | | 9230 | | | **TOTALI** | **1,801,661.91** |
| **5100** | 0 | 5100 | 5 | 231 | BLERJE KONTENIER PER MBETJET | 1,200,000.00 |
| | | 5100 | | | **TOTALI** | **1,200,000.00** |
| **3280** | 0 | 3280 | 1 | 231 | BLERJE AUTOMJET ZJARRFIKËS 4*4 | 8,392,269.52 |
| | 0 | 3280 | 5 | 231 | BLERJE AUTOMJET ZJARRFIKËS 4*4 | 30,000.00 |
| | | 3280 | | | **TOTALI** | **8,422,269.52** |
| **8220** | 0 | 8220 | 1 | 231 | BLERJE PAISJE PER SKENE PER AKTIVITETET | 83,452.44 |
| | 0 | 8220 | 5 | 231 | BLERJE PAISJE PER SKENE PER AKTIVITETET | 1,063,808.77 |
| | | 8220 | | | **TOTALI** | **1,147,261.21** |
| | | | | | **KAPITULLI 1** | **46,527,392.05** |

SHKIA LIBOHOVË

Adresa:Rruga"AvniRustemi",Lagjia"Linua",Libohovë,Tel :0035588122091,bashkialibohovë@outlook.com

| | |
|---|---|
| KAPITULLI 5 | 26,468,331.51 |
| TOTALI 1+5 | 72,995,723.56 |

Kërkojmë nga ana juaj miratimin e shpërndarjes së këtyre të ardhurave.

Me konsideratat më të larta!

**SHEF. SEKTORIT FINANCIAR**

**Joana Memo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr. 1169 prot** **Libohovë më 15.06.2026**

# VENDIM

**Nr. 28 Datë 10.06.2026**

**MBI**
**PËRDORIMIN E FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE TË MINISTRISË SË MBOJTJES PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar ,Nenin 29 të Ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", që parashikon përdorimin e burimeve financiare për përballimin e situatave të emergjencave civileVendimi Nr. 414, datë 8.7.2021 Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes të përdorimit të fondit të kushtëëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, (ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 290, datë 17.5.2023), Pika 3.1 shkronja ,h) likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre. Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 10.06.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,pasi morri në shqyrtim relacionin nga Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar për përdorimin e fondit të emergjencave civile të Ministrisë së Mbrojtjes,

**VENDOSI:**

**I.**Të miratohet përdorimi i fondit të emergjencave në shumën prej prej 478,500 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë për likujdimin e akomodimit te forcave të ushtrisë. për mbulimin e shpenzimeve të dietave të personelit ushtarak të angazhuar në përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet.

**II.**Fondi do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të ushqimit, akomodimit dhe dietave ditore të personelit ushtarak të dislokuar në zonat e prekura nga emergjenca.

**III.**Efektet financiare përballohen nga fondi i emergjencave civile, i miratuar për vitin buxhetor 2026.

**IV.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

**V.**Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**SEKRETARI I KËSHILLIT** | **KRYETARI I KËSHILLIT**

**Rahim Skënderi** | **Asim Banushaj**

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

Nr. 1113 Prot

**PROJEKT VENDIM**

Libohovë, më 09.06.2026

Nr. _____, Datë_____ ._____.2026

**MBI**
**PËRDORIMIN E FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE TË MINISTRISË SË MBOJTJES PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar ,Nenin 29 të Ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", që parashikon përdorimin e burimeve financiare për përballimin e situatave të emergjencave civileVendimi Nr. 414, datë 8.7.2021 Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes të përdorimit të fondit të kushtëëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, (ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 290, datë 17.5.2023), Pika 3.1 shkronja ,h) likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre

Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 10.06.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,pasi morri në shqyrtim relacionin nga Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar për përdorimin e fondit të emergjencave civile të Ministrisë së Mbrojtjes,

**VENDOSI:**

1. Të miratohet përdorimi i fondit të emergjencave në shumën prej prej 478,500 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë për likujdimin e akomodimit te forcave të ushtrisë. për mbulimin e shpenzimeve të dietave të personelit ushtarak të angazhuar në përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet.
2. Fondi do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të ushqimit, akomodimit dhe dietave ditore të personelit ushtarak të dislokuar në zonat e prekura nga emergjenca.

3. Efektet financiare përballohen nga fondi i emergjencave civile, i miratuar për vitin buxhetor 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

5. Ky vendim u shpall sot më datë ___.____.2026 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

| JURIST | SHEF.SEK FINANICAR | KRYETAR |
|---|---|---|
| Kristaq Ciko | Joana Memo | Leonard Hide |

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË
BASHKIA LIBOHOVË

**SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

# RELACION

Të nderuar këshilltar!

Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,
- të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"
- Ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar, veçanërisht dispozitat që rregullojnë përdorimin e fondeve dhe burimeve për përballimin e emergjencave civile;
- Nenin 29 të Ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", që parashikon përdorimin e burimeve financiare për përballimin e situatave të emergjencave civile;
- ", Vendimi Nr. 414, datë 8.7.2021 Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes të përdorimit të fondit të kushtëëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, (ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 290, datë 17.5.2023), Pika 3.1 shkronja ,h) likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre

Në bazë të aktmarrëveshjes nr. 86/1 prot., datë 16.01.2026, të lidhur ndërmjet Kryetarit të Bashkisë Libohovë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandës Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr. 4040, me nr. 160 prot., datë 23.01.2026, për mbështetje me forca dhe mjete në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e Bashkisë Libohovë, u ndërmorën veprime konkrete në Njësinë Administrative Zagori, në fshatrat Zhej dhe Lliar.

Si pasojë e reshjeve intensive të shiut gjatë fillimit të muajit janar 2026, në këto zona u shkaktuan rrëshqitje masive dherash, të cilat sollën bllokimin e plotë të akseve rrugore që lidhin fshatrat Zhej dhe Lliar me pjesën tjetër të njësisë administrative. Situata krijoi vështirësi të konsiderueshme për lëvizjen e banorëve, transportin e mallrave dhe aksesin e shërbimeve publike.

Duke qenë se Bashkia Libohovë nuk disrponte kapacitetet e nevojshme në mjete të rënda dhe fuqi punëtore për ndërhyrje të menjëhershme, u kërkua mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes, në zbatim të aktmarrëveshjes së sipërcituar.

Nga Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr. 4040, u organizuan grupe pune dhe mjete të specializuara, të cilat punuan për një periudhë prej 17 ditësh me qëllim hapjen, pastrimin dhe përmirësimin e segmenteve rrugore të dëmtuara, duke rikthyer qarkullimin normal në zonë dhe duke eliminuar rrezikun për komunitetin.

Në vijim, me shkresën nr. 160.3 prot., datë 18.02.2026, Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr. 4040, ka paraqitur kërkesën për likuidimin e shpenzimeve të akomodimit të forcave të angazhuara në terren, në vlerën prej **478,500 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë.**

Për sa më sipër, propozohet miratimi i përdorimit të **Fondit të Emergjencave Civile** për likuidimin e vlerës **478,500 lekë**,

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin kërkojmë bashkëpunimin tuaj për këtë ndryshim buxheti!

**Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar**
**Joana Memo**

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

**Nr.** 1170 **prot** **Libohovë më** 15 **.06.2026**

**VENDIM**

**Nr. 29 Datë 10.06.2026**

**MBI**

**NJË SHTESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 10.06.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtes në planifikimin e të ardhurave në Buxhetin e vitit 2026.

**VENDOSI:**

**I.**Të miratojë shtes në planifikimin e të ardhurave në buxhetin e bashkisë për 2026.

- **SHTOHET PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE:**

Gr.00, Kap. 05, Tit. 703, Artik. 7035, Nën/Artik. 7035003, "Taksë e ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja " me vlerën 1,900,000 ( një milion e nëntëqind mijë) lekë dhe Art.711 ,Nënart.7113001 " Shitja e produkteve bujqësore dhe pyjore" me vlerën 1,370,000 ( një million e treqind e shtatëdhjetë mijë)

- **SHTOHET PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE:**

Gr.00, Kap. 05, Tit. 6260, Artik. 231,"Investime", në emërtimin "Shtrim me kalldrëm i rrugës për tek kulla e Sahatit Libohovë" me vlerën 3.270.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

**II.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

**III.**Ky vendim hyn në fuqi në përputhje me piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI I KËSHILLIT** | **KRYETARI I KËSHILLIT** |
| **Rahim Skënderi** | **Asim Banushaj** |

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 1112 Prot

Libohovë, më 09.06.2026

Nr. _____, Datë_____ ._____.2026

**MBI**
**NJË SHTESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës _____._____ .2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtes në planifikimin e të ardhurave në Buxhetin e vitit 2026.

**VENDOSI:**

Të miratojë shtes në planifikimin e të ardhurave në buxhetin e bashkisë për 2026.

- **SHTOHET PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE:**

Gr.00, Kap. 05, Tit. 703, Artik. 7035, Nën/Artik. 7035003, "Taksë e ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja " me vlerën 1,900,000 ( një milion e nëntëqind mijë) lekë dhe Art.711 ,Nënart.7113001 " Shitja e produkteve bujqësore dhe pyjore" me vlerën 1,370,000 ( një millїon e treqind e shtatëdhjetë mijë)

- **SHTOHET PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE:**

Gr.00, Kap. 05, Tit. 6260, Artik. 231,"Investime"; në emërtimin "Shtrim me kalldrëm i rrugës për tek kulla e Sahatit Libohovë" me vlerën 3.270.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

2. Ky vendim u shpall sot më datë 10.06.2026 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

| | | |
|---|---|---|
| **JURIST** | **SHEF.SEK FINANICAR** | **KRYETAR** |
| **Kristaq Ciko** | **Joana Memo** | **Leonard Hide** |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBOHOVË**

**SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

# RELACION

Të nderuar këshilltar!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor",

Në bazë të shkresës së Sektorit të Tatim-Taksave me nr. 1000 prot., datë 26.05.2026, parashikimi i të ardhurave vendore për vitin 2026 rritet nga 15,672,300 lekë në 18,942,300 lekë, me një shtesë prej 3,270,000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila nga 600,000 lekë parashikohet të arrijë në 2,500,000 lekë, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga kontratat kullosore, të cilat kanë kaluar në administrim të Bashkisë Libohovë. Të ardhurat nga kullotat, të planifikuara fillimisht në vlerën 630,000 lekë, parashikohet të arrijnë në 2,000,000 lekë gjatë vitit 2026.

Duke marrë në konsideratë nevojat për investime dhe zhvillimin e turizmit në territorin e bashkisë, propozohet që shtesa e të ardhurave në vlerën 3,270,000 lekë të përdoret për financimin e investimit **"Shtrim me kalldrëm i rrugës për tek Kulla e Sahatit, Libohovë"**.

Aktualisht, pranë Kullës së Sahatit po zbatohet një projekt restaurimi i financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ndërsa rruga hyrëse që të çon drejt këtij monumenti kulture nuk është pjesë e këtij investimi. Përmirësimi i saj me kalldrëm guri do të krijojë kushte më të mira aksesimi për vizitorët dhe do të harmonizohet me karakterin historik dhe arkitektonik të monumentit, duke rritur më tej vlerat turistike të zonës.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i shtesës së të ardhurave në buxhetin e vitit 2026 dhe destinimi i tyre për investimin e sipërcituar.

**Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar**
**Joana Memo**

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

**BASHKIA LIBOHOVË**
**KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. 1171 prot                                                  Libohovë më 15.06.2026

# VENDIM

**Nr. 30 Datë 10.06.2026**

**MBI**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 10.06.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një ndryshim në Buxhetin e vitit 2026.

## VENDOSI

**I.**Të miratojë ndryshim në buxhetin e bashkisë për 2026.

- **PAKËSOHET:**

**Gr.00, Kap. 05, Tit. 10430 , Artik. 606 Nënartk. 6061003 " Transfertë për Ndihmë ekonomike" me vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.**

- **SHTOHET:**

